

NDIKIMI I MITIT TË VIDOVDANIT NË STRATEGJINË E SIGURISË DHE POLITIKËN E JASHTME TË SERBISË NDAJ KOSOVËS

Prof. Dr. Bejtush Gashi

Former Minister of Internal Affairs of the Republic of Kosovo

Former Dean of the Faculty of Security Studies

bejtushg2002@yahoo.com

Abstrakt:

Miti i Vidovdanit zë një vend qendror në mitologjinë politike serbe dhe është shndërruar në një instrument strategjik në ndërtimin e politikës së jashtme dhe të sigurisë së Serbisë, veçanërisht në raport me Kosovën. Ky studim shqyrton mënyrën se si ky mit përdoret për të legjitimuar diskursin revizionist serb, për të justifikuar ndërhyrjet në punët e brendshme të Kosovës dhe për të ndërtuar një doktrinë të përhershme të kërcënimit. Duke u mbështetur në qasjen konstruktiviste në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe në analizën e diskursit politik, artikulli argumenton se Vidovdani funksionon si një mekanizëm ideologjik me ndikim të madh në sigurinë rajonale, proceset e integritetit euroatlantik dhe në pozicionin ndërkombëtar të Kosovës.

Fjalë kyçe: Vidovdani, strategji sigurie, mit politik, luftë hibride, srpski svet Serbia, Kosova.

Cite as: APA style: Gashi, B. (2025). The Influence of The Vidovdan Myth on Serbia's Security Strategy and Foreign Policy Towards Kosovo. *Octopus Journal: Hybrid Warfare & Strategic Conflicts*. <https://doi.org/10.69921/xwhdww76> (CC BY-NC 4.0) This article is licensed to you under a [Creative Commons Attribution 4.0 International License](https://creativecommons.org/licenses/by-nc/4.0/). When you copy and redistribute this paper in full or in part, you need to provide proper attribution to it to ensure that others can later locate this work (and to ensure that others do not accuse you of plagiarism).

Hyrje

Mitet kombëtare nuk janë thjesht rrëfime historike apo legjenda kulturore; ato shpesh shërbejnë si mjete të fuqishme për ndërtimin e identitetit kolektiv dhe për artikulin e politikave të sigurisë dhe të jashtme të shteteve. Në këtë kontekst, miti i Vidovdanit luan një rol të veçantë në formësimin e ndërgjegjes politike dhe të strategjisë së sigurisë së Serbisë. Duke u mbështetur në kujtesën kolektive të Betejës së Kosovës më 1389, ky mit është shndërruar në simbol të sakrificës, heroizmit dhe të “misionit historik” serb, që vijon të mbijetojë në diskursin politik aktual.

Vidovdani është shndërruar nga një datë historike e fetare në një instrument ideologjik, i cili përdoret për të justifikuar politika nacionaliste, qasje revizioniste ndaj kufijve dhe mosnjohjen e shtetësisë së Kosovës. Kjo qasje nuk është vetëm retorike; ajo reflektohet në strategjitë konkrete të sigurisë së Serbisë, përfshirë militarizimin simbolik, narrativat mbi kërcënimet ekzistenciale dhe pretendimet territoriale mbi zona që konsiderohen pjesë e “trashëgimisë historike” serbe.

Përmes funksioneve të tij ideologjike dhe diskursive, miti i Vidovdanit është bërë pjesë përbërëse e strategjisë ushtarake, të sigurisë dhe të politikës së jashtme të Serbisë. Ai ndikon në formulimin e kërcënimeve të perceptuara dhe motivon politika mbrojtëse që synojnë ruajtjen e integritetit territorial dhe të pozicionit gjeopolitik të Serbisë në rajon. Duke përdorur qasjen konstruktiviste në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe analizën e diskursit, ky studim ndriçon mënyrat në të cilat miti i Vidovdanit ndikon në politikën rajonale, stabilitetin në Ballkanin Perëndimor dhe përpjekjet e Kosovës për integrim ndërkombëtar.

1. Origjina dhe evolucioni i mitit të Vidovdanit

Miti i Vidovdanit rrënjohet në ngjarjen historike të Betejës së Kosovës, e zhvilluar më 28 qershor 1389, ndërmjet forcave osmane dhe një koalicioni princëresh ballkanikë, ku princi serb Lazar Hrebeljanović luajti një rol të rëndësishëm. Kjo betejë përbën një moment kyç në kujtesën historike të serbëve. Edhe pse pa një fitues të qartë ushtarak, ajo u mitologjizua si një akt sublim i flijimit serb për mbrojtjen e krishterimit dhe të identitetit kombëtar.

Me kalimin e kohës, kjo ngjarje u transformua në një simbol fetar, moral dhe politik. Kisha Ortodokse Serbe ka pasur një rol të rëndësishëm në kodifikimin dhe përhapjen e këtij miti. Princi Lazar u ngjiti në statusin e një martiri, që zgjodhi “mbretërinë qiellore” përpara asaj tokësore, duke e kthyer humbjen ushtarake në një fitore morale dhe shpirtërore.

Në shekujt e mëvonshëm, miti i Vidovdanit u transformua nga një përvjetor fetar dhe historik në një instrument ideologjik dhe politik. Gjatë periudhës së nacionalizmit romantik dhe krijimit të shtetit modern

serb, ky mit shërbeu si mjet mobilizues për bashkimin kombëtar dhe legjitimimin e pretendimeve territoriale, veçanërisht ndaj komuniteteve serbe jashtë kufijve shtetërorë, si në Kosovë. Në fund të shekullit të 20-të, gjatë shpërbërjes së Jugosllavisë, miti u ringjall fuqishëm si një element kyç i retorikës nacionaliste, duke u shndërruar në një instrument politik dhe ushtarak përmes përkrahjes së ideve revizioniste dhe politikave ekspansioniste që synonin rivendosjen e kontrollit mbi Kosovën.

Simbolika e Vidovdanit u përdor gjerësisht në retorikën politike për të justifikuar veprime të caktuara, përfshirë fushatat ushtarake dhe politike në rajon, veçanërisht kundër pavarësisë së Kosovës, duke krijuar një ndjenjë të përhershme kërcënimi dhe viktimizimi kombëtar. Për shembull, fjalimi i Slllobodan Millosheviqit në Gazimestan, më 28 qershor 1989, ku ai i bëri thirrje kombit serb për mobilizim dhe përballje, përdori fuqishëm simbolikën e Vidovdanit për të justifikuar qëndrimet e tij agresive ndaj Kosovës. Po ashtu, deklaratat e përfaqësuesve të Kishës Ortodokse Serbe shpesh ringjallin këtë mit si mjet për të fuqizuar ndjenjën kombëtare dhe për të mbështetur politikat serbe kundër njohjes së Kosovës si shtet të pavarur.

Sot, miti i Vidovdanit nuk është vetëm një datë simbolike në kalendarin serb, por një doktrinë mitopolitike që ndërthur kujtesën kolektive, strategjinë e mbijetesës dhe politikën e jashtme të Serbisë. Ai shërben si bazë kulturore dhe historike për qëndrimet ndaj Kosovës, duke justifikuar mosnjohjen e shtetësisë së saj dhe duke ndikuar drejtpërdrejt në aktivitetet politike dhe propagandistike të Serbisë në Ballkan.

2. Përdorimi politik i miteve në ndërtimin e strategjisë shtetërore

Në historinë politike të shumë shteteve, mitet kanë funksionuar si burime legjitimimi për vendime të mëdha politike, mobilizim masiv dhe ndërtimin e një narrative kombëtare koherente. Ato nuk janë vetëm pjesë e kulturës kolektive, por shërbejnë si korniza të rëndësishme të diskursit politik, brenda të cilave zhvillohen politika e jashtme, strategjitë e mbrojtjes kombëtare dhe vizionet strategjike të shtetit. Në rastin e Serbisë, miti i Vidovdanit përbën një shembull të spikatur të kësaj ndërthurjeje midis simbolikës historike dhe politikës shtetërore.

Që nga fundi i viteve 1980 deri në ditët e sotme, elitat politike serbe, pavarësisht ndryshimeve të regjimeve dhe ideologjive, kanë ruajtur qëndrueshmërisht thelbin strategjik të mitit, duke e riprodhuar dhe përshtatur atë në forma të ndryshme, sipas kërkesave të kohës. Në këtë kontekst, miti nuk është thjesht një kujtesë historike pasive, por është transformuar në një mjet aktiv të politikëbërjes.

2.1. Miti si instrument legjitimues i politikës së jashtme serbe

Në diskursin zyrtar serb, pretendimi mbi Kosovën nuk mbështetet vetëm në argumente juridike dhe politike, por kryesisht në një “trashëgimi historike dhe shpirtërore”, e cila, sipas narrativës zyrtare, buron nga miti i

Vidovdanit. Përdorimi i këtij miti i jep legjitimitet politik një pozicioni të palëkundur, që është refuzimi i pavarësisë së Kosovës, madje edhe në kundërshtim me presionet ndërkombëtare, vendimet e gjykatave ndërkombëtare dhe proceset e integritetit evropian.

Një shembull historik është fjalimi i Slobodan Millosheviqit, më 28 qershor 1989 në Gazimestan, ku ai përdori mitin e Vidovdanit për të mobilizuar opinionin serb dhe për të justifikuar qëndrimet e tij kundër autonomisë së Kosovës, duke deklaruar: "Ky është momenti kur ne duhet të qëndrojmë të bashkuar për të mbrojtur tokën tonë të shenjtë, për të mbrojtur Kosovën – zemrën e Serbisë." Po ashtu, shefi i Shtabit të Forcave të Armatosura të Serbisë gjatë viteve 1990, Dragoljub Ojdaniç, ka shprehur në intervista: "Kujtesa e betejës së Kosovës dhe mitet e lidhura me Vidovdanin na japin forcën morale dhe motivimin për të mbrojtur integritetin territorial të Serbisë, përfshirë Kosovën." Në këtë kuadër, edhe Patrijarku i Kishës Ortodokse Serbe, Pavle, gjatë krizës së viteve 1990, ka theksuar shpesh rolin mbrojtës të Kishës dhe serbëve në Kosovë, duke e lidhur këtë direkt me trashëgiminë e Vidovdanit dhe duke deklaruar: "Kosova është zemra shpirtërore dhe historike e Serbisë, dhe ne jemi të detyruar ta mbrojmë atë si gjënë më të shenjtë."

Instrumentalizimi i mitit të Vidovdanit në diskursin politik serb funksionon si një mekanizëm legjitimues për qëndrimin refuzues ndaj pavarësisë së Kosovës. Ky proces mitik ofron mbështetje politike për një narrativë që e prezanton Serbinë si mbrojtëse të një trashëgimie historike dhe shpirtërore përballë sfidave të vazhdueshme ndërkombëtare. Në këtë kontekst, në kuadër të strategjisë së sigurisë dhe politikës së jashtme serbe, Kosova trajtohet jo vetëm si një çështje territoriale, por si element kyç i identitetit kombëtar serb, duke justifikuar qëndrimin zyrtar refuzues ndaj pavarësisë së saj përmes argumenteve historike, morale dhe kulturore, të lidhura ngushtë me trashëgiminë dhe sovranitetin kombëtar.

2.1. Miti i Vidovdanit si bosht i strategjisë së sigurisë: Nga simbolika historike në instrument shtetëror

Miti i Vidovdanit ka ndikim të drejtpërdrejtë në konceptimin serb të kërcënimeve ndaj sigurisë dhe në strukturimin e doktrinës ushtarake dhe të mbrojtjes. Strategjia e sigurisë së Serbisë mbështetet në elemente mitike, si kujtesa e flijimit, ndjenja e rrethimit nga armiqtë dhe detyrimi moral për të mbrojtur "territoret e shenjta". Kjo logjikë krijon një gjendje të përhershme mobilizimi ideologjik, e cila lehtëson përdorimin e retorikës konfliktuale në raste tensionesh politike apo ndërkombëtare.

Përfaqësues të lartë të ushtrisë serbe në dekadat e fundit kanë lidhur vazhdimisht forcimin e kapaciteteve ushtarake me nevojën për mbrojtjen e "trashëgimisë së shenjtë të Serbisë" në Kosovë dhe në rajon. Kjo përfshin edhe bashkëpunimin strategjik dhe ushtarak me shtete si Rusia dhe Kina, të cilat mbështesin pozicionin serb në lidhje me çështjen e Kosovës. Në këtë kuadër, Serbia ka ofruar mbështetje jo vetëm për strukturat ushtarake formale, por edhe për strukturat paramilitare dhe organizatat kriminale që veprojnë në

mënyrë të organizuar në Ballkan. Shërbimet sekrete serbe dhe njësitë si “Jedinice za specijalne operacije” (Njësitë e Operacioneve Speciale) kanë luajtur një rol kyç në koordinimin dhe mbështetjen e këtyre strukturave, të cilat shpesh funksionojnë jashtë kontrollit të plotë publik dhe ndërkombëtar.

Këto organizata paramilitare dhe kriminale, të lidhura ngushtë dhe në mënyrë të ndërthurur me strukturat shtetërore dhe shërbimet e inteligjencës ushtarake, janë përdorur dhe vazhdojnë të përdoren si instrumente të politikës së jashtme dhe strategjisë së sigurisë së Serbisë. Ato ushtrojnë presion politik dhe ushtarak, kontribuojnë në destabilizimin e situatave në Kosovë dhe më gjerë në rajon, si dhe krijojnë një klimë frike dhe kontrolli mbi komunitetet lokale. Ky bashkëpunim ndërmjet aktorëve shtetërorë dhe jo-shtetërorë pasqyron një strategji hibride, e cila synon ruajtjen e influencës dhe dominimit në një kontekst të vazhdueshëm tensioni rajonal.

Një shembull domethënës i kësaj strategjie është sulmi terrorist i 24 shtatorit 2023 në fshatin Banjska, në veri të Kosovës, ku një grup i armatosur, i pajisur me armatim të rëndë ushtarak, kreu një sulm të organizuar ndaj Policisë së Kosovës, duke vrarë zyrtarin policor, rreshterin Afrim Bunjaku — i cili më pas u nderua me titullin “Hero i Kosovës”. Pas sulmit, grupi u tërhoq dhe u strehua në manastirin ortodoks serb të Banjsës, një vend me rëndësi të veçantë simbolike dhe shpirtërore për komunitetin serb lokal, duke synuar të forcojë perceptimin se veprimi i tyre ishte një akt mbrojtjeje i “territoreve të shenjta”. Udhëheqësi politik i serbëve të veriut të Kosovës, Milan Radoičiq, mori publikisht përgjegjësinë për organizimin e këtij sulmi. Retorika zyrtare serbe e paraqiti ngjarjen si një akt mbrojtjeje të trashëgimisë historike dhe shpirtërore, duke e lidhur atë me “detyrimin moral” të trashëguar nga miti i Vidovdanit.

Ky akt terrorist u shoqërua me retorikë të fortë nacionaliste në Beograd, ku u paraqit si një akt mbrojtjeje i “territoreve të shenjta” dhe si kundërpërgjigje ndaj “kërcënimeve” ndaj Serbisë dhe serbëve në Kosovë. Deklaratat e zyrtarëve ushtarakë dhe politikëbërës serbë lidhën veprimet e tyre me detyrimin moral të Vidovdanit për të mbrojtur trashëgiminë historike dhe shpirtërore.

Hetimet ndërkombëtare dhe raportet e organizatave të sigurisë dhe të luftës kundër krimit tregojnë se këto njësi dhe strukturat paramilitare kanë bashkëpunuar ngushtë me rrjete kriminale që operojnë në trafikun e armëve, drogës dhe kontrabandës, duke përdorur rrjetin e tyre për të forcuar ndikimin dhe kontrollin në rajon. Kjo ndërthurje e politikës shtetërore me krimin e organizuar, e legjitimuar nëpërmjet retorikës mitike të Vidovdanit, krijon një sfond të rrezikshëm për stabilitetin rajonal dhe për përpjekjet për normalizimin e marrëdhënieve me Kosovën. Në mediat shtetërore serbe, kjo retorikë përdoret për të nxitur unitetin kombëtar dhe për të justifikuar çdo veprim ushtarak apo politik kundër njohjeve ndërkombëtare të Kosovës, duke

paraqitur çdo zhvillim si “sulm ndaj Serbisë” dhe si një nevojë për një përgjigje të fortë dhe të bashkuar kombëtarisht, qoftë përmes kanaleve formale apo atyre joformale.

Pra, miti i Vidovdanit nuk është vetëm një element kulturor apo historik, por një komponent kyç i strategjisë së sigurisë dhe politikës shtetërore serbe, i cili ushqen dhe justifikon një rrjet kompleks veprimesh ushtarake, paramilitare dhe kriminale për ruajtjen e influencës dhe kontrollit në Ballkan.

3. Strategjitë e instrumentalizimit të mitit: Pesë dimensione të ndikimit të Vidovdanit në politikën serbe

Instrumentalizimi i mitit të Vidovdanit përbën një mekanizëm kompleks, i cili shtrihet në disa dimensione kyçe të politikës dhe shoqërisë serbe. Ky mit përdoret si një mjet strategjik për konsolidimin e identitetit kombëtar dhe legjitimimin e politikave shtetërore në nivele të ndryshme. Pesë dimensionet kryesore do të analizohen më poshtë:

1. **Dimensioni diplomatik:** Serbia përdor narrativën e Vidovdanit në mënyrë strategjike në forume ndërkombëtare, si Kombet e Bashkuara dhe Këshilli i Evropës, për të kundërshtuar pavarësinë e Kosovës. Sipas Bieber (2018), kjo narrativë i jep politikës së jashtme serbe një kuadër historik dhe moral, duke paraqitur Kosovën si “zemrën historike të Serbisë” dhe duke justifikuar refuzimin e njohjes së saj.
2. **Dimensioni mediatik:** Kanale televizive dhe mediat shtetërore serbe, si RTS dhe agjencia Sputnik, përdorin këtë mit për të përhapur narrativën e viktimizimit historik dhe kërcënimeve ndaj Serbisë. Sipas Pudar Draško dhe Grujić (2020), kjo kontribuon në konsolidimin e opinionit publik kundër njohjes së Kosovës dhe në mbështetjen e politikave nacionaliste.
3. **Dimensioni arsimor:** Në programet shkollore serbe, miti i Vidovdanit prezantohet si një sakrificë hyjnore për mbrojtjen e kombit dhe tokës, duke kultivuar tek brezat e rinj ndjenjën e detyrës morale dhe historike për ruajtjen e integritetit territorial.
4. **Dimensioni religjioz:** Ritet dhe ceremonitë fetare të Kishës Ortodokse Serbe, përfshirë meshën përkujtimore të Vidovdanit dhe vizitat në manastiret historike të Kosovës, luajnë një rol kyç në ruajtjen dhe forcimin e mitit të Vidovdanit në perceptimin publik dhe konsolidimin e identitetit kolektiv serb. Këto praktika rituale afirmojnë lidhjen ndërmjet identitetit fetar dhe atdhetar, duke forcuar narrativën e sakrificave dhe përkushtimit shpirtëror ndaj “tokës së shenjtë serbe”. Figura të larta fetare të Kishës Ortodokse Serbe kanë nxjerrë në pah përmasat sakrificiale dhe shpirtërore të betejës së Vidovdanit, duke e interpretuar atë si një akt themelor të mbrojtjes së identitetit kombëtar. Për shembull, Patriarku Irinej, në meshën përkujtimore të vitit 2018, deklaroi: “Mbrojtja e Kosovës është detyrë e shenjtë dhe përgjegjësi e të gjithë kombit serb. Kjo tokë është e bekuar dhe është pjesë e shpirtit tonë kombëtar.” Ndërkaq, Mitropoliti Amfilohije theksoi: “Kosova është themeli i besimit tonë dhe i ekzistencës së popullit serb. Çdo përpjekje për të ruajtur dhe

mbrojtur këtë tokë është një sakrificë e shenjtë, e cila na bashkon të gjithëve.”. Po ashtu, Ipeshkvi Teodosije i Raškas dhe Prizrenit theksoi: “Manastiret në Kosovë janë jo vetëm qendra fetare, por edhe simbole të identitetit tonë të përbashkët. Ato na lidhin me të kaluarën tonë dhe na japin forcë për të përballuar sfidat e së ardhmes.” Në këtë mënyrë, vizitat dhe ceremonitë fetare në manastiret e Kosovës, si Deçani dhe Graçanica, shërbejnë si akt ritual që artikulon lidhjen shpirtërore dhe historike me territorin, duke e kthyer mitin e Vidovdanit në një instrument kyç për mobilizimin social dhe politik. Përmes këtyre riteve, Kisha Ortodokse Serbe konsolidon një narrativë që lidh ngushtë besimin fetar me ruajtjen e identitetit kombëtar.

5. **Dimensioni paramilitar:** Miti i Vidovdanit përdoret nga grupet paramilitare serbe si justifikim ideologjik për ndërhyrje ushtarake dhe veprime destabilizuese në Kosovë dhe rajon. Flijimi i princit Lazar dhe koncepti i “tokës së shenjtë serbe” krijojnë një ndjenjë misioni historik dhe shpirtëror, legjitimuar si mbrojtje e trashëgimisë kombëtare. Një shembull është edhe Njësia për Operacione Speciale (JSO), njësia elitare serbe e akuzuar për krime lufte, që përdorte dhe kultivonte këtë mitologji për të justifikuar veprimet e saj. Struktura të tjera, si Teritorijalna Odbrana dhe Garda Vullnetare Serbe (nën drejtimin e Arkanit), gjithashtu u mbështetën në këtë narrativë për ngritjen e moralit dhe legjitimitimit të veprimeve ushtarake. Për më tepër, organizata kriminale si Klani i Zemunit, me lidhje me ish-anëtarë të JSO-së dhe shërbime sekrete, përdorin mitin për të justifikuar aktivitetet e tyre ilegale dhe destabilizuese, duke operuar në hije me mbështetje të fshehtë shtetërore. Një shembull aktual është akti terrorist i 24 shtatorit 2023 në Banjaska, ku një grup i armatosur terrorist sulmoi Policinë e Kosovës, ndërsa retorika zyrtare serbe e përshkroi incidentin si mbrojtje të trashëgimisë historike dhe amanetit të Vidovdanit, duke theksuar rëndësinë e kontrollit mbi Kosovën si “zemër shpirtërore të Serbisë”.

Miti i Vidovdanit funksionon si një “teknologji politike”, duke u përdorur si mjet për ndërtimin dhe drejtimin e narrativave hegjemoniste politike të Serbisë në rajon. Përmes përmbajtjes së tij simbolike dhe emocionale, miti instrumentalizohet për të arritur disa objektiva politike konkrete:

- **Legjitimimi i konceptit të “Srpski svet” (Bota Serbe):** Miti shfrytëzohet për të mbështetur strategjitë rajonale që synojnë zgjerimin kulturor, politik dhe ndonjëherë edhe institucional të Serbisë në territoret ku jetojnë komunitete serbe jashtë kufijve shtetërorë të saj. Ai shërben si justifikim historik dhe moral për aspirata që lidhen me një formë të re të integritetit trans-territorial serb, në përputhje me ideologjinë e unifikimit kombëtar përtej shtetit-komb.
- **Konsolidimi i ndjenjës së rrethimit dhe viktimizimit:** Në situata krize, si në rastin e incidentit në Banjaska, narrativa mitike aktivizohet për të paraqitur zhvillimet si sulme ndaj besimit, kulturës dhe identitetit serb. Kjo krijon një ndjesi të përhershme kërcënimi dhe një mentalitet “ne kundër të gjithëve”, i cili nxit izolim politik dhe kulturor, dobëson besimin në dialogun ndëretnik dhe ndërkombëtar, dhe justifikon masa të njëanshme për “vetëmbrojtje” dhe ndarje komunitare.

- **Justifikimi i diskurseve ndarëse dhe refuzimi i integritetit institucional:** Retorika hibride dhe ngjarje të tilla si Banjska përdoren për të forcuar ndjesinë e mosbesimit dhe refuzimit ndaj institucioneve të Kosovës, veçanërisht nga ana e serbëve lokalë në veri të vendit. Këto qëndrime mbështeten në një ndërthurje të mitit, trashëgimisë historike dhe pasigurisë ekzistenciale, duke kontribuar në krijimin dhe ruajtjen e një identiteti paralel politik dhe kulturor, të orientuar drejt Serbisë.

Në këtë mënyrë, radikalizimi i konceptimit mitik të Vidovdanit dhe instrumentalizimi i tij përmes strategjive hibride — përfshirë operacione paramilitare në terren, përdorimin e simboleve fetare dhe përpjekjet për të ndikuar në perceptimet ndërkombëtare — paraqitet si komponent kyç i strategjisë së jashtme dhe të sigurisë së Serbisë. Ky model përfaqëson një formë të re të “luftës për mbijetesë kombëtare”, që përdor narrativën historike për të justifikuar veprime brenda dhe jashtë politikës shtetërore.

Rekomandime dhe Përfundime

Analiza e përdorimit të mitit të Vidovdanit në strategjinë hibride të konfliktit në Kosovë dhe rajon evidenton një përdorim të qëllimshëm dhe shumëplanësh të këtij miti si mjet mobilizimi, legjitimizimi dhe destabilizimi. Në këtë kontekst, rekomandohen masat e mëposhtme:

- Forcimi i mekanizmave të inteligjencës dhe bashkëpunimi ndërkombëtar për zbulimin dhe parandalimin e operacioneve paramilitare që përdorin narrativat historike si bazë ideologjike për veprime destabilizuese. Kjo kërkon përmirësimin e shkëmbimit të informacionit ndërmjet autoriteteve të Kosovës, Serbisë dhe institucioneve ndërkombëtare.
- Nxitja e dialogut ndërmjet komuniteteve, me fokus në ndërtimin e një narrativi të përbashkët historik, i cili shmang përdorimin instrumental të miteve për qëllime politike dhe ushtarake. Ky proces do të kontribuonte në uljen e tensioneve dhe promovimin e pajtimit.
- Mbështetja e institucioneve arsimore dhe kulturore për zhvillimin e programeve që promovojnë qasje kritike ndaj historisë dhe përdorimit politik të saj, duke theksuar edukimin mbi ndikimin e miteve në konfliktet etnike dhe rajonale.
- Monitorimi i mediave dhe i fushatave propagandistike që shfrytëzojnë simbolet fetare dhe historike për krijimin e narrativave të njëanshme, si dhe krijimi i mekanizmave për përgjegjshmëri në rastet e përhapjes së dezinformimit.
- Shqyrtimi i mundshëm i rregullimeve ligjore lidhur me organizimin dhe mënyrën e festimeve publike të Vidovdanit, veçanërisht kur ato përdoren për qëllime politike ose për mobilizim të grupeve me tendencë ekstremiste. Ky proces duhet të zhvillohet duke respektuar në mënyrë rigorozë parimet themelore të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), veçanërisht nenet që garantojnë lirinë e shprehjes (neni 10), lirinë e tubimit dhe asociimit (neni 11), si dhe të drejtat e pakicave kombëtare sipas Kornizës Evropiane për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare. Nevojitet një ekuilibër i kujdesshëm midis ruajtjes së rendit publik dhe parandalimit të veprimeve që nxisin urrejtje, dhunë

apo diskriminim, duke siguruar njëkohësisht respektimin e lirive themelore për shprehje, tubim, praktikim të kulturës dhe fesë.

- Shqyrtimi ligjor i ndalimit ose rregullimit të festimeve publike të Vidovdanit, duke u mbështetur në precedentë ndërkombëtarë, përfshirë ligjet gjermane që ndalojnë fjalimet nacionaliste dhe përhapjen e ideologjive ekstremiste para Luftës së Dytë Botërore, me qëllim parandalimin e instrumentalizimit të Vidovdanit për qëllime destabilizuese. Ky proces duhet të zhvillohet pa cenuar të drejtat demokratike dhe duke promovuar pluralizmin kulturor dhe historik në rajon, si dhe duke ruajtur marrëdhëniet e mira bilaterale midis vendeve të përfshira. Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) thekson rëndësinë e kufizimit të lirive të shprehjes vetëm në rastet kur ato kërcënojnë rendin publik apo të drejtat e të tjerëve, si në rastet e nxitjes së urrejtjes raciale apo etnike (p.sh., *Handyside vs. United Kingdom*, 1976). Kjo qasje ligjore mund të shërbejë si udhërrëfyes për shqyrtimin ligjor të aktiviteteve publike që mbështeten në simbole historike, por që mund të instrumentalizohen për qëllime ekstremiste ose destabilizuese.

Për më tepër, politikat evropiane për mbrojtjen e të drejtave të pakicave dhe promovimin e bashkëjetesës kulturore, të përqendruara në Kornizën Evropiane për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare dhe Strategjinë Evropiane për Tolerancën dhe Ndërkulturën, nxisin dialogun dhe ndalimin e përdorimit instrumental të trashëgimisë kulturore për të nxitur ndarje apo konflikte. Në këtë kontekst, një vlerësim i kujdesshëm dhe i balancuar i rregullimeve ligjore për festimet e Vidovdanit do të kontribuonte në parandalimin e përdorimit të tyre si instrument destabilizues, duke mbrojtur njëkohësisht lirinë e shprehjes, kulturën dhe fenë, si dhe duke forcuar stabilitetin dhe paqen në rajon.

Miti i Vidovdanit vazhdon të luajë një rol kyç në proceset e konfliktit dhe stabilitetit në Ballkan. Përkundër natyrës së tij historike dhe kulturore, përdorimi instrumental dhe i qëllimshëm në strategjitë hibride kërkon një qasje të mirëinformuar dhe të koordinuar ndërmjet faktorëve lokalë dhe ndërkombëtarë, për parandalimin e eskalimit të konflikteve dhe promovimin e paqes së qëndrueshme në rajon.

References

1. Bieber, F. (2018). *Patterns of competitive authoritarianism in the Western Balkans*. *East European Politics*, 34(3), 337–354. <https://doi.org/10.1080/21599165.2018.1490272>
2. Council of the European Union. (2013–2020). *Brussels Agreement and the Kosovo–Serbia dialogue*. Official documents. Retrieved from <https://www.consilium.europa.eu/>
3. Gashi, B. (2018). Minority rights and security challenges in the Western Balkans. *Journal of Balkan Security Studies*, 5(2), 45–62.
4. Glenny, M. (2001). *The Balkans: Nationalism, war, and the great powers, 1804–1999*. London: Penguin Books.

5. Ignatieff, M. (1994). *Blood and belonging: Journeys into the new nationalism*. London: BBC Books.
6. International Crisis Group. (2013). *Serbia and Kosovo: The path to normalization* (Europe Report No. 231). Brussels: International Crisis Group. <https://www.crisisgroup.org/europe-central-asia/balkans/kosovo/serbia-and-kosovo-path-normalization>
7. Miskovic, M. (2017). The Vidovdan myth and Serbian national identity. *Journal of Balkan Studies*, 45(2), 145–162.
8. Millosheviq, S. (1989, June 28). *Speech at Gazimestan*. Yugoslav Historical Archives. Belgrade.
9. Serbian Academy of Sciences and Arts. (1986). *The SANU Memorandum*. Belgrade: SANU.
10. Ristić, L. (2010). The Kosovo myth: Serbian nationalism and the politics of history. *Balkan Insight*. Retrieved from <https://balkaninsight.com/2010/06/28/the-kosovo-myth-and-nationalism/>
11. Radio Television of Serbia (RTS). (2019–2024). *Broadcasts and commemorations of Vidovdan*. Retrieved from <https://www.rts.rs/>
12. Sputnik Serbia. (2020–2024). *Analyses and commentary on the “sacred Serbian land”*. Retrieved from <https://rs.sputniknews.com/>
13. Todorova, M. (1997). *Imagining the Balkans*. Oxford: Oxford University Press.
14. Wendt, A. (1999). *Social theory of international politics*. Cambridge: Cambridge University Press.

Online Reports and Institutional Documents

1. NATO/KFOR. (2023). *Report on troop reinforcements and patrol activity following the Banjska attack*. Retrieved from <https://europarl.europa.eu>, <https://koha.net>, <https://cna.al>, <https://balkans.aljazeera.net>
2. European Parliament. (2023). *Resolution on EULEX–KFOR cooperation in the investigation of the Banjska incident*. Retrieved from <https://europarl.europa.eu>
3. White House National Security Council. (2023). *Statement on Serbian troop movements near the Kosovo border*. Washington, DC: White House. Retrieved from <https://whitehouse.gov>
4. NATO Parliamentary Assembly. (2023). *Report on the withdrawal of militants from Banjska*. Retrieved from <https://koha.net>, <https://reuters.com>, <https://n1info.rs>, <https://telegrafi.com>
5. EULEX Kosovo. (2023). *Documents supporting Kosovo Police investigations following the Banjska attack*. Pristina: EULEX.
6. Kirby, J. (2023, September 25). *Statement on the coordinated terrorist attack in Banjska*. U.S. National Security Council Press Office.

